

1 1

**REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA**

C.nr.38/2010

**GJYKATA THEMELORE NI MITROVICE** (ne objektin e Deges se kesaj Gjykate ne Vushtrri) gjyqtari Skender Shala, ne çeshtjen juridike te paditesit nga Mitrovica, te cilin e perfaqeson avokati nga Mitrovica, sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditurit . . . . . nga Mitrovica, tani me vendbanim te panjohur, te cilin e perfaqeson perfaquesuesi i perkohshem avokati . . . . . nga Mitrovica, sipas aktvendimit te kesaj gjykate, baza e kontestit: Vertetim pronesie, vlera e kontestit 1.250,00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe publik, te dt.27.12.2013, bie kete:

**A K T G J Y K I M**

**I – APROVOHET** kerkespadia e paditsit dhe **VERTETOHET** se paditesi nga Mitrovica eshte pronar i pjeses se parceles katastrale nr. . . . . , me kultur Are, e klasses se trete, ne vendin e quajtur „ . . . . . ”, me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne siperfaqe prej **S=571m<sup>2</sup>**, e cila evidentohet ne emer te te paditurit Ademi Sajji, sipas çertifikates se pronesise me nr. te lendet . . . . . ZK. Mitrovice .

**II – OBLIGOHET** i padituri qe t'ia njoh kete te drejte paditesit dhe t'i lejone qe paditesi kete paluajtshmeri ta regjistroje ne emer te tij, ne librat e tokes te Zyra Kadastrale Komunale ne Mitrovica, ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

Secila pale i barre shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

**A r s y e t i m**

Paditesi ne padin e tij te parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tij ne seancat e mbajtura ka theksuar se gjyshi I tij qysh ne vitin . . . . . , ne baze te marveshjes gojore, e ka blere nga i padituri paluajtshmerin e cekur si ne dispozitiv per shumen kontraktuese prej 21.000.000 din te athershem dhe qe nga momenti i shitblerjes I njejti se bashku me familjen e tij ka hyre ne posedim te prones, ku ne vazhdimesi e ka shfrytezuar pa asnje lloj kufizimi apo pengese. Paditesi tani vone e ka kuptuar qe paluajtshmeria e cila eshte ne posedim faktik te tij qe nga blerja e saj nuk evidentohet ne emrin e tij, andaj, ka interes juridik qe kjo paluajtshmeri edhe juridikisht te evidentohet ne emrin e tij.

Pasi qe te paditurit jane ne adrese te panjohur i propozojë gjykates qe te ua caktoi perfaqesuesin e perkohshem.

I autorizuari i paditsit ne seancen e shqyrtimit kryesor beri precizimin e kerkesapdisse sa I perket siperfaqes , shtrirjes dhe perkufizimit te paluajtshmerise dhe ate sipas konstatimit dhe mendimit te ekspertit gjeodet e edhe sa I perket te te paditureve si ne ekspertize. Ne fjalen e tij perfundimtare theksoi se nga provat e nxjerrura ne shqyrtimin e sotem ne menyre te pakontestueshme u vertetua bazushmerija e kerkespadise . Andaj, Gjykates I propozoj qe te njejten ta aprovoj si te bazuuar .

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesit e konform nenit 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK-es, gjykata me aktvendimin C.nr.38/2008 te dt.07.11.2013, te paditurve ua caktoi Perfaqesuesin e perkohshem, av. Rerxhep Kaqaniku, i cili ne baze te ketij aktvendimi do t'i ushtron te drejtat dhe detyrimet, konform nenit 82.1.2 te LPK-es.

Perfaqesuesi i perkohshem i te paditurve ne perjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise te paditesit ne shqyrtimin kryesor dhe ne fjalen perfundimtare Gjykates I propozoj qe conform rrezultatit te provave ne proceduren provuese te bie vendim meritor lidhur me kete ceshtje juridike-civile.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor, zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-es, erdhia ne perfundim se duhet vendsur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi nga keto arsy'e.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: cartifikaten e prones me nr.12-6538, te dt.09.12.2013 ZK Mitrovice, ne emer te paditurit Procesverbalin mbivendshiqim C.nr.38/08 te dt. 04.12.2013, Lexoit ekspertizen e ekspertit Nuhi Mehmeti I dt. 09.12.2013, Beri veshrtim ne skicen e terenit dhe situacionin e terrenit dhe kopja e planit nga eksperti gjeodet ndegjoi deshmitarin nga Mitrovica dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga fleta pseduese te cekur me lart, konstatohet se pjesa e parceles katastrale nr.3525-1, evidentohet ne emer te te paditurit

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me lart, konstatohet se pas matjeve te kryera te pjesees kontestuese te paluajtshmerise nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit, me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Kadastrit ne Mitrovice, ka vertetuar se paluajtshmerija kontestuese bjen - gjegjesisht e perbenc pjeset e parceles te cekur me larte me masa dhe kufij te shnuara si ne ekspertizen e dhene me shkrim dhe ne skicen e terenit, e cila eshte pjese perberse te kesaj ekspertize dhe te aprovuar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga procesverbali mbi vendeshiqimini kesaj gjykate te cekur me larte konstatohet se gjyqtari me vrojtim te drejtperdrejte ne vend konstatoi se paluajtshmerija kontestuese eshte e kufizuar ne anen veriore dhe perendimore me prone private, ne anen lindore me rruge te karakterit dytsor dhe ne anen jugore me rruge kryesore ne drejtimin Mitrovicë - Skenderaj. Ne kete paluajtshmeri gjinden objekte te ndertuara dhe ate shtepija (P+1) e ndretuar ne vitin (sipas ekspertit). Paluajtshmerija eshte e rrethuar ne anen perendimore me cokulle prej betoni, ne anen lindore dhe jugore me taraba prej druri ndersa ne anen lindore me mur perj bilokave te betonit.

Deshmitari babegjyshi I tije me emrin deklaroi se ai personalisht e din se paraardhesi I paditesit – e ka blere ne vitin 1979-80, nga shitsi I cili me duket se ka qene boshnjak emir I te cilit tani per tani nuk me kujtohet, ne superfaqe prej treth 6 ari, me cmim te shitblerjes qe tani per tani nuk me kujtohet. Nuk me kujtohet se I njefti u ja ka paguar te hollat ne teresi, por e di se komuna ia ka pas marre patundeshmerin te Stacioni I autobusave tani rr. ! dhe me ato te holla e ka blere ate patundshmeri. Nuk kam njojuri se me rastin e shitblerjes eshte nenshkruar ndonje marreveshje por ata jane marr vesh gojarisht. E di se prej momentit te blerjes kan hyr ne shfrytzim dhe posedim te asaj patundeshmerie dhe per sa e di une prej momentit te shitblerjes e ka shfrytezuar pa kurrfar pengesash dhe pa p protestuar nga personat tjere, pra e shfrytzuar ne menyre te ligjshme. Ne ate paluajtshmeri kane qene 2 shteti te vjetra e me vone I kane rrrenuar dhe e kane ndertuar nje shteti te re e cila ka perafersisht 20 vite. Keto trethana deshmitarit I Jane te njojura sepse ai te njetin e ka djale te tezes dhe ka shku te ai dhe ai ka ardhur te ky.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me lart, gjykata erdhi ne perfudim dhe konstatoi se patundshmerin tani lendore e ka blere gjyshi I paditesit, ne baze te marreveshjes gojore ne vitin 1979, dhe se qmimin e shitblerjes, shitesit ia ka paguar ne teresi, te cilen shitesi menjehet i'a ka lene ne disponim dhe shrytezim te lire kete paluajtshmeri gjyshit te paditsit – tani paditesit i cili se bashku me anetaret e familjes se tij e ka shfrytezuar pa pengesa qe nga momenti i shitblerjes e tani e tutje e shfrytezon.

Ne baze te nenit 28 p 4 te LMTHJP eshte percaktuar se: Mbajtesi me mirebesim I sendit te palucjtshem, mbi te cilin tjetri ka te drejten e pronsise, fiton te drejten e pronsise mbi kete send me parashkrimin fitues me kalimin e kohes prej 20 (njezet) vjetesh.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes, paditesi e ka pasur ne shfrytezim dhe disponim te lire kete paluajtshmeri dhe ate: me mirebesim dhe pa pengesa nga askush, andaj ne anen e paditesit ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronesise ne baze te mbajtjes e keto Jane: mbajtja me mirebesim, koha e nevojshme si dhe shfrytezimi i papengueshem i ketyre paluajtshmerive.

Mbajtja me mirebesim ekziston nga Mbajtja me mirebesim ekziston nga se gjyshi i paditsit kete paluajtshmeri e ka blere nga shitesi

Koha e nevojshme mbi 20 (njezet) vite, ekziston sepse babai i paditesit e ka blerc kete paluajtshmeri nga e paditura, qysh nga viti 1979.

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes, parardhesi I ppaditsi (gjyshi) e tani edhe paditesi ka hyre ne posedim dhe shfrytezim te lire dhe te papengueshem te kesaj paluajtshmerive te tij, gjere me tani.

Andaj, gjykata konkludon, se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesit me mbajtje, konform nenit 28 p 4 te LMTHJP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore, bazaohet ne baze te nenit 450 dhe 459 te LPK-es.

Nga te cekurat me lart u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**  
**C.nr.38/2010, dt.27.12.2013.**

**Gjyqtari,  
Skender Shala**

**KESHILLE JURIDIKE:** Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa, ne afat prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.

**Saktesin e pershkrimit e verteton:**